



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
DREJTORIA E PROKURIMIT
NJESIA E PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. _____ Prot.

Fier, më _____ 06.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje Uniforma per Policine Bashkiake dhe Drejtorine e Sherbimit te MZSH-se, Bashkia Fier”, me 2 lote:

Loti 1: Blerje Uniforma per Policine Bashkiake .

Loti 2: Blerje Uniforma per Drejtorine e Sherbimit te MZSH-se.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

35811200-4 - Uniforma policie; 35811100-3 - Uniforma zjarr-fikësish

VLERA E FONDIT LIMIT: fond limit të përbashkët total, të përlogaritur prej **7 490 000.33** (shtate milion e katerqind e nentedhjete mije pike tridhjete e tre) **lekë pa TVSH dhe 8 988 000.39** (tete milion e nenteqind e tetedhjete e tete mije pike tridhjete e nente) **lekë me TVSH** , vënë në dispozicion nga buxheti i Bashkisë Fier , i ndarë sipas Loteve si më poshtë:

Loti 1: Blerje Uniforma per Policine Bashkiake është **1 255 333.33** (nje milion e dyqind e pesedhjete e pese mije e treqind e tridhjete e tre pike tridhjete e tre) **lekë pa TVSH dhe 1 506 399.99** (nje milion e peseqind e gjashte mije e treqind e nentedhjete e nente pike nentedhjete e nente) **lekë me TVSH,**

Loti 2: Blerje Uniforma per Drejtorine e Sherbimit te MZSH-se është **6 234 667** (gjashte milion e dyqind e tridhjete e kater mije e gjashteqind e gjashtedhjete e shtate) **lekë pa TVSH dhe 7 481 600.4** (shtate milion e katerqind e tetedhjete e nje mije e gjashteqind pike kater) **lekë me TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Fier ka

hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

LOTI 1: BLERJE UNIFORMA PËR POLICINË BASHKIAKE

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas Shtojcës 9*

Argumentimi: Ky kriter u vendos bazuar në nenin 82 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në të cilën është e përcaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”

b. *Sigurim oferte, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilën është e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) *vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës;*

b) *çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga operatori ekonomik ofertues gjatë 2 (dy) viteve të fundit (**2024, 2025**) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më pak se **400 000 leke pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet- **për Lotin 1**). Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 3 të nenit 77 të ligjit nr. 162/2020 "Per Prokurimin Publik" i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilanci të tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës.; në pikën 1 dhe pikën 2/c të nenit 43 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, ku përcaktohet se: Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika 2/c: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar;

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur me sukses kontratën sic është parashikuar nga AK. Kriteri i mesipër është në përputhje dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Pika 1 dhe pika 2/c e nenit 43 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, parashikon marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur e thjeshtuar, përkatësisht; Pika 2/c: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar; Duke qenë se kjo procedurë prokurimi është bazuar në vlerën e fondit limit nën kufirin e ulët monetar, AK duke u bazuar në eksperiencën e suksesshme të procedurave të zhvilluara më parë gjykon se është e përshtatshme vendosja e kriterit të marzheve maksimale të përcaktuara në Legjislacionin dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare; si dhe në Ligjin nr.29/2023 "Për Tatimin Mbi të Ardhurat"* i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore të ardhurave; Njësia e prokurimit ka gjykuar të nevojshme përcaktimin e dy viteve të fundit në përputhje me vlerën e fondit limit të parashikuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë *dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit*. Në këto rast vlera e kërkuar është jo më pak se **200 000 leke pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet- **për Lotin 1**), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Per të vertetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët Ekonomik duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me një ent publik, si dëshmi pranohen:
- Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës ku shënohen vlera, afati I perfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
 - ose Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës ku shënohen vlera, afati I perfundimit të kontratës,
 - ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 40, pika 4 dhe nenit 55 pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se **200 000 lekë pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet) që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, pikën 4 të nenit 40 dhe pikën 4/b të nenit 55 të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën sa 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë teknike të OE ofertues, duke vertetuar nepermjet përvojës

se meparshme, se zoterojne kapacitet dhe aftesine teknike per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.

2.3.2. Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese certifikate te menaxhimit te cilesise **ISO 9001-2015 ose ekuivalente e saj** per objektin qe prokurohet **për Lotin 1** (e cila duhet te jete e perkthyer ne shqip dhe e noterizuar) e leshuar nga Organizmat e Vleresimit te Konformitetit, te cilat jane te akredituara nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga Organizmat Nderkombetare Akreditues te njohura ne Republiken e Shqiperise. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).

2.3.3. Operatori ekonomik duhet të deklarojë nëse është prodhues ose distributor i autorizuar nga prodhuesi për artikujt për këtë objekt prokurimi ose është subjekt tregtar i artikujve objekt prokurimi i autorizuar nga Prodhuesi ose Distributori i autorizuar i Prodhuesit.

Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese Autorizim Prodhuesi ose Autorizim nga Distributori i autorizuar nga Prodhuesi, për artikujt objekt prokurimi. Ne rast se do te paraqitet Autorizim nga Distributori i autorizuar nga Prodhuesi, duhet te provohet edhe lidhja midis Prodhuesit dhe Distributorit te autorizuar.

Secili nga dokumentat duhet te jete i vlefshem, nese eshte ne gjuhe te huaj duhet te jete i perkthyer ne shqip dhe i noterizuar, si dhe te permbaje te dhena te plota te prodhuesit ose distributorit te autorizuar si: tel, fax, email, website, etj., kjo e nevojshme per AK ne rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar ; pika 6/b dhe pika 8, e nenit 40, të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar ku është e cituar: *8.Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës*”, gjithashtu ne mbështetje te Rekomandimit nr.7998 prot, date 24.12.2021 te Agjencise se Prokurimit Publik, “*Rekomandim mbi hartimin e kriterëve per kualifikim per procedurat e prokurimit per mallra, pune sherbime*”.

Autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave.

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi.

Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe se mallrat e ofruara janë konform të gjitha standarteve dhe ne përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.

2.3.4. Stafi kryesor e mbështetës, punonjësit, certifikimet, kualifikimet per ekzekutimin e kontratës.

Operatori ekonomik ofertues, duhet te kete ne stafin e tij në listepagesën e shoqërisë për muajin Maj 2026, ose me kontrate pune te vlefshme per periudhen e realizimit te kontrates, edhe inxhinierin si më poshtë:

1. Inxhinier tekstili 1 (një);

Për inxhinierin duhet të paraqiten: Diploma, Kontratë individuale pune (e vlefshme).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në K.Punës, legjislacionin për sigurimet shoqerore (pushimet, leje e zakonshme).

Ky kriter shërben për të vërtetuar se ofertuesit kanë pesonel të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kërkesat lidhen ngushte dhe janë në proporcion me objektin e prokurimit.

Autoriteti Kontraktor (njesia e prokurimit) ka kerkuar paraqitjen e listepageses se muajit **Maj 2026**, per arsye se eshte muaji i fundit i maturuar duke u nisur nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates. Bazuar ne ligjin nr.9136 date 11.09.2003 “Per mbledhjen e kontributeve te detyrueshme te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore ne Republiken e Shqiperise” i ndryshuar (*Neni 11 Afatet e deklarimit dhe te pagesës*), operatoret ekonomike kane afat te shlyejne detyrimet per sigurimet shoqerore e shendetesore brenda dates 20 te muajit pasardhes.

Shënim: Operatoret ekonomike te cilet do te paraqesin ofertat/ konkurrojnë per me shumë se nje lot, duhet te plotesojne kriteret e veçanta,xhiron vjetore sipas pikes 2.2.1., dhe pervojen e ngjashme sipas pikes 2.3.1. si shumë të loteve për të cilat konkurrojnë.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

LOTI 2: BLERJE UNIFORMA PËR SEKTORIN E MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMI

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas Shtojcës 9

Argumentimi: Ky kriter u vendos+ bazuar ne nenin 82 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e

Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar, ne te cilen eshte e percaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”

b. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 te ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, ne te cilen eshte e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2.Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga operatori ekonomik ofertues gjatë 2 (dy) viteve të fundit (**2024, 2025**) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo me pak se **2 000 000 lekë pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet - **për Lotin 2**). Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Ky kriter eshte vendosur ne perputhje me piken 3 te nenit 77 te ligjit nr. 162/2020 “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, ne te cilen gjejme te percaktuar se: 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës.; ne piken 1 dhe piken 2/c te nenit 43 te VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku percaktohet se: Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet

e fundit financiare. Pika 2/c: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40% te vlerës se parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nen kufirin e ulët monetar;

Vendosja e këtij kriteri behet me qellim qe Autoriteti Kontraktor te sigurohet per aftesine ekonomike dhe financiare te OE ofertues, duke vertetuar nepermjet dokumenteve te kerkuara, se zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten sic eshte parashikuar nga AK. Kriteri i mesiperme eshte ne perpjestim dhe i lidhur ngushte me objektin e kontrates.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Pika 1 dhe pika 2/c e nenit 43 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar, parashikon marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur e thjeshtuar, perkatesisht; Pika 2/c: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40% te vlerës se parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nen kufirin e ulët monetar; Duke qene se kjo procedure prokurimi eshte bazuar ne vleren e fondit limit nen kufirin e ulët monetar, AK duke u bazuar ne eksperiencen e suksesshme te procedurave te zhvilluara me pare gjykon se është e pershtatshme vendosja e kriterit te marzheve maksimale të përcaktuara në Legjislacionin dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare; si dhe ne Ligjin nr.29/2023 “Për Tatimin Mbi të Ardhurat”* i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore e të ardhurave; Njesia e prokurimit ka gjykuar te nevojshme percaktimin e dy viteve te fundit ne perputhje me vleren e fondit limit te parashikuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë *dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit.* Ne kete rast vlera e kerkuar eshte jo me pak se **1 000 000 leke pa TVSH** (e cila eshte nje vlerë jo më e madhe se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet- **për Lotin 2**), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.

Per te vertetuar pervojen e meparshme te ngjashme, operatoret Ekonomik duhet te paraqesin deshmitte e meposhtme:

a)Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me nje ent publik , si deshmi pranohen:

-Vërtetime të lëshuara nga një ent public per permbushjen me sukses te kontrates ku shënohen vlera, afati I perfundimit te kontrates dhe fatura tatimore të shitjes, te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara ,
ose Vërtetime të lëshuara nga një ent publik per permbushjen me sukses te kontrates ku shënohen vlera, afati I perfundimit te kontrates ,
ose fatura tatimore të shitjes, te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 40, pika 4 dhe nenit 55 pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo me pak se **1 000 000 lekë pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet) që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, piken 4 te nenit 40 dhe piken 4/b te nenit 55 të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën sa 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosja e ketij kriteri behet me qellim qe Autoriteti Kontraktor te sigurohet per aftesine teknike te OE ofertues, duke vertetuar nepermjet pervojese meparshme, se zoterojne kapacitet dhe aftesine teknike per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.

2.3.2. Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese certifikate te menaxhimit te cilesise **ISO 9001-2015 ose ekuivalente e saj** per objektin qe prokurohet **për Lotin 2** (e cila duhet te jete e perkthyer ne shqip dhe e noterizuar) e leshuar nga Organizmat e Vleresimit te Konformitetit, te cilat jane te akredituara nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga Organizmat Nderkombetare Akreditues te njohura ne Republiken e Shqiperise. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).

2.3.3. Operatori ekonomik duhet të deklarojë nëse është prodhues ose distributor i autorizuar nga prodhuesi për artikujt për këtë objekt prokurimi ose është subjekt tregtar i artikujve objekt prokurimi i autorizuar nga Prodhuesi ose Distributori i autorizuar i Prodhuesit.

Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese Autorizim Prodhuesi ose Autorizim nga Distributori i autorizuar nga Prodhuesi, për artikujt objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet Autorizim nga Distributori i autorizuar nga Prodhuesi, duhet të provohet edhe lidhja midis Prodhuesit dhe Distributorit të autorizuar.

Secili nga dokumentat duhet të jete i vlefshëm, nese eshte ne gjuhe te huaj duhet te jete i perkthyer ne shqip dhe i noterizuar, si dhe te permbaje te dhena te plota te prodhuesit ose distributorit te autorizuar si: tel, fax, email, website, etj., kjo e nevojshme per AK ne rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar ; pika 6b dhe pika 8, e nenit 40, të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar ku është e cituar: *8.Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës*”, gjithashtu në mbështetje të Rekomandimit nr.7998 prot, date 24.12.2021 të Agjencisë së Prokurimit Publik, “*Rekomandim mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, pune shërbime*”.

Autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave.

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, garantohej se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi.

Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe se mallrat e ofruara janë konform të gjitha standarteve dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.

2.3.4. Staf i kryesor dhe mbështetës, punonjësit, certifikimet, kualifikimet për ekzekutimin e kontratës.

Operatori ekonomik ofertues, duhet të ketë në stafin e tij në listepagesën e shoqërisë për muajin Maj 2026, ose me kontratë pune të vlefshme për periudhën e realizimit të kontratës, edhe inxhinierin si më poshtë:

2. Inxhinier tekstili 1 (një);

Për inxhinierin duhet të paraqiten: Diploma, Kontratë individuale pune (e vlefshme).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në K.Punës, legjislacionin për sigurimet shoqërore (pushimet, leje e zakonshme).

Ky kriter shërben për të vërtetuar se ofertuesit kanë personel të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kërkesat lidhen ngushtë dhe janë në proporcion me objektin e prokurimit.

Autoriteti Kontraktor (njesia e prokurimit) ka kerkuar paraqitjen e listepageses se muajit **Maj 2026**, per arsye se eshte muaji i fundit i maturuar duke u nisur nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates. Bazuar ne ligjin nr.9136 date 11.09.2003 “Per mbledhjen e kontributeve te detyrueshme te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore ne Republiken e Shqiperise” i ndryshuar (*Neni 11 Afatet e deklarimit dhe te pagesës*), operatoret ekonomike kane afat te shlyejne detyrimet per sigurimet shoqerore e shendetesore brenda dates 20 te muajit pasardhes.

Shënim: Operatoret ekonomike te cilet do te paraqesin ofertat/ konkurrojnë per me shumë se nje lot, duhet te plotesojnë kriteret e veçanta, xhiron vjetore sipas pikes 2.2.1., dhe pervojen e ngjashme sipas pikes 2.3.1. si shumë të loteve për të cilat konkurrojnë.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike per Lotin1 dhe Lotin 2

Specifikimet teknike jane hartuar dhe argumentuar nga grupet e punes te ngritura nga zv.Kryetari i Bashkisë me Urdhërin nr.3789 prot datë 25.03.2026 dhe me urdher nr.3789 prot datë 25.03.2026 dhe derguar me shkresen nr.5975 prot date 12.05.2026, dhe me shkresen nr.6513 prot date 21.05.2026 si dhe ne perputhje me nenin 4, pika 38/b, nenin 36 te ligjit nr.162/2020, “Per Prokurimin Publik”, nenin 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar dhe me V.K.M nr.494 date 24.08.2023 “Per miratimin e uniformes, shenjave dalluese dhe modelit te dokumentit individual te identifikimit, ngjyres, shenjave dhe perdorimit te mjeteve levizese te Policise Bashkiake” dhe V.K.M nr.1153 date 24.12.2020 “Per miratimin e uniformes, shenjave dalluese perkatese, flamurit dhe stemes se sherbimit te mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimin’”. Kriteret teknike te vecanta te kualifikimit lidhur me kapacitetin teknik jane hartuar e argumentuar nga grupet e punes te ngritura nga zv.Kryetari i Bashkisë me Urdhërin nr.3789 prot datë 25.03.2026 dhe me urdher nr.3789 prot datë 25.03.2026.

Specifikimet teknike gjenden bashkelidhur DST në SPE.

Argumentimi I specifikimeve teknike Loti 1: Blerje Uniforma per Policine Bashkiake :

Specifikimet teknike për objektin “Blerje uniforma për Policinë Bashkiake” janë hartuar në përputhje me kërkesat e Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe VKM nr. 285/2021 (i ndryshuar) , si dhe jane te percaktuara ne V.K.M nr.494 date 24.08.2023 “Per miratimin e uniformes, shenjave dalluese dhe modelit te dokumentit individual te identifikimit, ngjyres, shenjave dhe perdorimit te mjeteve levizese te Policise Bashkiake”. Këto specifikime janë të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe janë formuluar në mënyrë të tillë që të sigurojnë akses të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë, pa krijuar kufizime të pajustificuara, në përputhje me nenin 36 të ligjit “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar. Kërkesat teknike janë përcaktuar mbi bazën e nevojave funksionale të Drejtorise se Policise Bashkiake, duke synuar garantimin e cilësisë, qëndrueshmërisë dhe sigurisë në përdorim. Parametrat e materialeve, përbërjes dhe rezistencës janë vendosur në mënyrë proporcionale me funksionin e uniformave dhe kushtet e përdorimit në terren, ndërsa referimi në standarde ndërkombëtare për artikuj të veçantë është bërë për të garantuar performancë dhe siguri, pa favorizuar prodhues të caktuar. Ne V.K.M nr.494 date 24.08.2023 “Per miratimin e uniformes, shenjave dalluese

dhe modelit të dokumentit individual të identifikimit, ngjyres, shenjave dhe perdorimit të mjeteve levizese të Policisë Bashkiake” përbën bazën ligjore dhe referencën zyrtare mbi të cilën është mbështetur Autoriteti Kontraktor për përcaktimin e periudhave të garancisë, duke garantuar përputhshmërinë me normativat e miratuara dhe me kërkesat funksionale të shërbimit.

Argumentimi I specifikimeve teknike Loti 2: Blerje Uniforma per Drejtorine e Sherbimit te MZSH-se.

Specifikimet teknike për objektin “Blerje uniforma për Drejtorinë e Sherbimit të MZSH” janë hartuar në përputhje me kërkesat e Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe VKM nr. 285/2021, si dhe janë të percaktuara në V.K.M nr.1153 date 24.12.2020 “Për miratimin e uniformes, shenjave dalluese perkatese, flamurit dhe stems se sherbimit te mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimin”. Këto specifikime janë të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe janë formuluar në mënyrë të tillë që të sigurojnë akses të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë, pa krijuar kufizime të pajustificuara, në përputhje me nenin 36 të ligjit “Për Prokurimin Publik”. Kërkesat teknike janë përcaktuar mbi bazën e nevojave funksionale të Drejtorisë së MZSH-se, duke synuar garantimin e cilësisë, qëndrueshmërisë dhe sigurisë në përdorim. Parametrat e materialeve, përbërjes dhe rezistencës janë vendosur në mënyrë proporcionale me funksionin e uniformave dhe kushtet e përdorimit në terren, ndërsa referimi në standarde ndërkombëtare për artikuj të veçantë është bërë për të garantuar performancë dhe siguri, pa favorizuar prodhues të caktuar. V.K.M nr.1153 date 24.12.2020 “Për miratimin e uniformes, shenjave dalluese perkatese, flamurit dhe stems se sherbimit te mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimin” përbën bazën ligjore dhe referencën zyrtare mbi të cilën është mbështetur Autoriteti Kontraktor për përcaktimin e periudhave të garancisë, duke garantuar përputhshmërinë me normativat e miratuara dhe me kërkesat funksionale të shërbimit.

Specifikimet teknike nuk kane asnje kerkese apo reference te ndonje marke apo emri te vecante, patente, vizatim ose tip ose origjinë ose prodhim specifik, pervec kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme e saktë ose e kuptueshme e pershkrimit te kerkesave me kusht qe fjala “ose ekuivalent” perfshihet detyrimisht ne keto specifikime.

Shenim: *Ne cdo rast kur ne specifikimet teknike dhe preventive mund te jete perdorur si reference emri i ndonje marke apo emri te vecante, patente, vizatim ose tip ose origjinë ose prodhim specifik, perfshihet dhe fjala “ose ekuivalent” i saj.*

Njësia e Prokurimit:
